



## DREJTORIA PËR ARSIM

DATA :	04.05.2026
NUMËR :	106/26
PËR :	Të interesuarit për aplikim për subvencione në Drejtorinë për Arsim
NGA :	Drejtoria për Arsim , Adriatik Zeqiri
LËNDA :	Njoftim për vazhdimin e afatit të aplikimit për subvencione në Drejtorinë për Arsim sipas thirrjes publike me numer 405 të datës 01.04.2026 dhe vendimit me numer 677 të datës 16.04.2026

### NJOFTIM PËR VAZHDIM TË AFATIT TË APLIKIMIT

Lidhur me Thirrjen Publike për aplikim për ndarjen e ndihmës momentale për studentët e Komunës së Fushë-Kosovës për vitin akademik 2025/2026, ju njoftojmë se afati për aplikim vazhdohet.

Afati i ri për aplikim është shtyrë deri më datë 15 maj 2026.

Të gjithë kandidatët e interesuar që nuk kanë arritur të aplikojnë brenda afatit të paraparë, mund të dorëzojnë aplikimet e tyre brenda këtij afati shtesë, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në thirrjen publike.

Aplikimi bëhet në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në Komunën e Fushë-Kosovës.

Aplikimet e pakompletuara dhe ato të dorëzuara pas këtij afati nuk do të shqyrtohen.

Faleminderit për mirëkuptim.